



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 75, datë 18.04.2025

PËR

KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË TITULLIN E OBJEKTIT TË VENDIMIT
NR. 17 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, DATË 25.09.2024 “PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN “OBJEKT SHËRBIMI DHE
BANIMI 11, 12, 13, 14, 15 16 KATE MBI TOKË ME 4 KATE PARKIM NËNTOKË” ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN “FORTUZI”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të Nenit 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Korrigjimin e gabimit material në titullin e objektit të Vendimit Nr.17 datë 18.04.2025 të Këshillit Kombëtar të Territorit: nga “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin “Objekt shërbimi dhe banimi 11, 12, 13, 14, 15 16 kate mbi tokë **me 4 kate parkim nëntokë**” me vendndodhje në Rrugën “Fortuzi”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “TDT & Partners” sh.p.k”, në “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin “Objekt shërbimi dhe banimi 11, 12, 13, 14, 15 16 kate mbi tokë **me 5 kate parkim nëntokë**” me vendndodhje në Rrugën “Fortuzi”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “TDT & Partners” sh.p.k”.
2. Përmbajtja dhe të gjithë kushtet e tjera të Vendimit të KKT-së Nr.17, datë 25.09.2024, mbeten të pandryshuara.
3. Ndryshimet e bëra në këtë vendim i shtrijnë efektet që nga data 25.09.2024.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02.05/2025